

## SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Menaxhment Programi: Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Ekonomia në Ndërmarrësi dhe Inovacion</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi i lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Semestri:</b>	<b>I</b>
<b>Numri orëve në javë:</b>	<b>4</b>
<b>Vlera në kredi:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	
<b>Detajet kontaktuese:</b>	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me përmbajtjen e ekonomisë menaxheriale; Analizën e tregut- ndërtimin e modelit dhe statikën krahasuese; Kufizimin buxhetor, taksat dhe subvencionimin; Analizën e preferencave të veçanta dhe ndërtimin e kurbave të tyre të indiferencës, analizën e dobisë dhe zgjedhjen optimale për preferencat përkatëse; Struktura e tregut, Analizën e ekuilibrit të tregut; Teorinë dhe vlerësimin e prodhimit; Maksimizimin e fitimit dhe analizën e kostove të prodhimit; Tregun e faktorëve të prodhimit; Monopoli: Konkurenca monopolistike dhe Oligopoli: Teorinë e lojërave dhe sjelljen strategjike, si dhe eksternalitetet dhe të drejtat pronësore
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Ky modul do t'i pajisë studentët me njohuri për ekonominë menaxheriale dhe lidhjet e tij me ndërmarrësinë dhe inovacionin, teorinë e kërkesës së konsumatorit dhe kërkesës së prodhuesve, efektet e ndryshimeve të çmimit në agjentët ekonomik; të ardhurat dhe efektet e zëvendësimit në kërkesën dhe ofertën dhe përdorimi i tyre nga qeveria dhe të punësuarit. Tatimet dhe implikimet e tyre në mirëqenie, struktura e tregut dhe efektet në çmime dhe outpute, eficaenca ekonomike dhe roli i eksternaliteteve në të mirat publike.
<b>Rezultatet e pritura të mësimnxënies:</b>	Pas përfundimit e këtij moduli, studentët do të: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aplikon principet e ekonomisë në ndërmarrësi dhe inovacion;</li> <li>2. Percepton dhe kupton reagimet e konsumatorit dhe sjelljen e prodhuesve;</li> <li>3. Përdor të ardhurat dhe efektet e zëvendësimit për të analizuar çmimet dhe ndryshimet e tatimeve dhe të ilustrojnë preferencat e konsumatorëve;</li> <li>4. Interpreton në formë kritike sesi struktura e tregut influencon vendimet për çmimet dhe outputet;</li> <li>5. Vlerëson faktorët të cilët influencojnë inputet e tregut;</li> <li>6. Zbaton teorinë ekonomike për çështje dhe probleme praktike ekonomike</li> </ol>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Ligjërata</b>	<b>3</b>	<b>15</b>	<b>45</b>
<b>Ushtrimet teorike/detyra</b>	<b>1</b>	<b>15</b>	<b>15</b>
<b>Punë praktike</b>			
<b>Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet</b>			
<b>Ushtrime në terren</b>			
<b>Kollokuium – seminar</b>			
<b>Detyra të shtëpisë</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>10</b>
<b>Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)</b>			<b>50</b>
<b>Përgatitja përfundimtare në provim</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>15</b>
<b>Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>5</b>
<b>Projektet, prezantimet etj</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>10</b>
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)</b>	Gjatë këtyre orëve të ligjëratave do të shtjellohet materiali mësimor, do të zhvillohet mësim interaktiv duke përfshirë përvojat dhe njohuritë nga ekonomia menaxheriale për ndërmarrjet dhe inovacionin, diskutimet individuale dhe në grupe, si dhe kohëpaskohe do të organizohen teste të vetëvlerësimit, poashtu do të aplikohet mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, angazhim për studentin për të prezantuar njohuritë e fituara gjatë ligjërates dhe prezantimi i punimeve ndërlidhur me materialin e përpunuar.		
<b>Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)</b>	<p>Vlerësimi dhe forma e ndërtimit të notës për studentet do të mbështetet në tre aktivitetet e mëposhtme:</p> <p><b>1. Aktiviteti dhe angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët e mundshme,</b></p> <p>Aktiviteti në mësim - nënkupton që studenti të jetë aktiv dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave.</p> <p>Angazhimi - nënkupton që studenti t'i kryej dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjërate dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjërates vijuese.</p> <p><b>2. Hartimi dhe prezantimi i një detyre, projekti/punimi seminarik, vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët e mundshme,</b></p> <p>Brenda semestrit studenti (mund të jete një grup i studenteve – jo më shumë se 3 studentë) duhet të përgatit një detyrë, projekt/punim seminarik (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim.</p> <p>Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori,</p>		

	<p>dhe e njëjta duhet te jete ne korrelacion te plote me lenden.</p> <p><b>3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë nga 100 pikët e mundshme,</b></p> <p>Studenti ka te drejtë t'i nënshtrohet provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit te provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit.</p> <p>Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathhtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësimnxënies se parapare për materialin e lendes se ligjëruar.</p> <p>Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet te plotësohet ne mënyrë individuale nga studentit dhe i njëjti përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• pyetje objektive, te njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës,</li> <li>• pyetje subjektive te llojit ese/detyre me shkrim për te cilat vete studentit duhet te jete ne gjendje te jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lendes se ligjëruar, te njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe vlerësim të problemit.</li> </ul> <p>Studentët pasi i nënshtrohen provimit, do të ndërtojnë notën përfundimtare:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>max 10 pikë</b> - aktiviteti dhe angazhimi në mësim,</li> <li>• <b>max 20 pikë</b>- hartimi dhe prezantimi i detyrës, projektit, punimi/hulumtimit,</li> <li>• <b>max 70 pikë</b> - provimi final (ose nga dy testet),</li> </ul> <p><b>Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë nga te gjitha kriteret e vlerësimit,</b></p>
<b>Mjetet e konkretizimit – TI</b>	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, etj.
<b>Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit</b>	70% Teori, 30% Ushtrime,
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. William F. Samuelson and Stephen G. Marks;, Managerial Economics , 2011</li> <li>2. Hubbard, G., &amp; O'Brien, A., (2019). Economics, 7th Edition, Boston: Pearson Education.</li> <li>3. Dominick Salvatore, “Managerial Economics in a global economy”, Thompson Learning/ SouthWestern, SHBA, fifth edition, 2004.</li> </ol>
<b>Literatura shtesë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ahmet Mançellari, “Ekonomiksi menaxherial”, Tiranë 2012.</li> <li>2. Parkin, M., (2019). Economics, 13th Edition, Boston: Pearson Education.</li> </ol>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	<b>Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Hyrje në ekonominë menaxheriale;</b> Është ligjeratë hyëse, Studentet njoftohen me planprogramin e lëndes, natyrën dhe përmbajtjen e ekonomisë menaxheriale, konceptet bazike ekonomike, nderlidhja me ndermarrësinë dhe inovacionin. Rezultati i pritur nr.1
Java e dytë	<b>Kërkesa-Elasticiteti i kërkesës;</b> Ne këte ligjeratë studentët do të njoftohen me Analizën dhe vlerësimin e kërkeses, teorinë e kërkeses, Faktoret që ndikojnë në kërkesë, Elasticiteti i kërkeses, Matja e kërkeses etj. Rezultati i pritur nr.1,2,4 dhe 5.
Java e tretë	<b>Kufizimi buxhetor;</b> Gjate ketij leksioni do të kemi ushtrime dhe ligjerata ku studentet do të njoftohen me kufizimin buxhetor dhe tiparet e zonës buxhetore. Si ndryshon vija e buxhetit? Variabli njësi. Taksat, subvencionet dhe racionimi. Rezultati i pritur nr.1,3 dhe 6.
Java e katërt	<b>Preferencat e konsumatorit;</b> Ne këte ligjerate do të kemi ushtrime dhe ligjerata ku studentet do të njihen me Preferencat e konsumatorit, supozimet rreth tyre dhe kurbat e indiferencës. Lloje të ndryshme kurbash indiference dhe norma marxhinale të zëvendësimit duke marrë shembuj të ndryshëm nga jeta e përditshme mbi preferencat e konsumatoreve. Rezultati i pritur nr.1,2,3,4,5 dhe 6.
Java e pestë	<b>Funksioni i dobisë;</b> Në këte ligjerate do të diskutohet dhe perseriten ligjeratat paraprake duke bërë nderlidhje me ligjeratën në vazhdim për t'u njohur me Kuptimin e funksionit të dobisë. Ndërtimin e një funksioni dobie dhe dobie kardinale Lloje të ndryshme kurbash indiference (preferencat pothuajse lineare) etj. Rezultati i pritur nr. 2, 3,4 dhe 6.
Java e gjashtë	<b>Kërkesat e konsumatorit dhe Zgjedhja optimale;</b> Ne këte ligjeratë do të kemi ushtrime dhe ligjerata ku studentet do të njihen me Kërkesat e konsumatorit dhe zgjedhjen optimale, duke marrë Shembuj: zëvendësuesit e plotë, bashkëplotësuesit e plotë, të mirat asnjëse dhe mallra të padëshiruara, të mirat në njësi të pandashme. Preferencat konkave. Rezultati i pritur nr.1, 2,3,4 dhe 6.
Java e shtatë	<b>Struktura e tregut;</b> Ne këte ligjerate nga studentet do të kërkohet mendim për ecurinë e ligjëratarave dhe sugjerime eventuale për ndryshim apo përmirësim, ku me tej do të sqarohen konkurrenca e plote, Kuptimi dhe rëndësia e konkurrencës së plote, diskriminimi i çmimit në konkurrencën e plote, konkurrenca rajonale dhe globale. Rezultati i pritur nr.1,4 dhe 5.
Java e tetë	<b>Oferta dhe Ekuilibri;</b> Ne këte ligjerate do të kemi ushtrime dhe ligjerata ku studentet do të njihen me Faktoret që përcaktojnë ofertën Ekuilibrit, Disekuilibrit. Çmimet tavan dhe çmimet dysHEME, duke marrë shembuj nga jeta e përditshme mbi ofertën kërkeses, ekuilibrit, tepriçen dhe mungesën të ekuilibrit të tregut, etj. Rezultati i pritur nr.1,2,4 dhe 5.
Java e nëntë	<b>Teoria dhe vlerësimi i prodhimit;</b> Ne këte ligjerate do të këte

	perseritje te materialit te zhvilluar, studentet do te njihen me Organizimin e prodhimit dhe funksionin e prodhimit. Funksionin e prodhimit me vetem nje input variabel. Funksioni i produktit me dy inpute variabile. Produkti total, mesatar dhe margjinal. Izokostet dhe Izokuantet, etj. Rezultati i pritur nr.1 dhe 5.
<b>Java e dhjetë</b>	<b>Maksimizimi i fitimit;</b> Ne këtë ligjëratë do te ketë diskutime interaktive me fokus përsëritje te ligjëratës paraprahe pastaj studentet do te njoftohen me Fitimet dhe vlera e tregut të aksioneve. Faktorët e pandryshueshëm dhe faktorët e ndryshueshëm të prodhimit. Maksimizimi i fitimit në periudhë afatshkurtër. Maksimizimi i fitimit në periudhë afatgjatë. Kurba e anasjelltë e kërkesës për faktorë. Maksimizimi i fitimit dhe të ardhurat e shkallës. Rezultati i pritur nr.1,4,5 dhe 6.
<b>Java e njëmbëdhjetë</b>	<b>Teoria e Vlerësimit te shpenzimeve</b> (kostove); Ne kete ligjeratë do te ketë diskutime interaktive për materialin e lëndës se përpunuar, duke u kyqur ne nderkohe te Kostot afatshkurta dhe funksionet e kostos per njesi, kostot afatgjate, kostot mesatare dhe kostot margjinale, Ekonomizimi i shkalles, Minimizimi i kostove, etj. Rezultati i pritur nr.1,4,5 dhe 6.
<b>Java e dymbëdhjetë</b>	<b>Monopoli;</b> Ne kete ligjerate do te kete perseritje, studentet do te njoftohen me Burimet e monopolit, barrierat e hyrjes tek monopoli, krahasimi i monopolit me konkurenbcen e plote, Raste studimore te monopolit. Rezultati i pritur nr.1,4 dhe 5.
<b>Java e trembëdhjetë</b>	<b>Konkurenca monopolistike dhe Oligopoli;</b> Ne kete ligjeratë do te kete perseritje te materialit te shpjeguar duke u nderlidhur me kuptimin dhe rendesine e konkurences monopolistike. Karakteristikat e konkurences monopolistike. Oligopoli dhe koncentrimi i tregut. Burimet e oligopolit. Modelet e oligopolit, si dhe do te behet prezantimi i projekteve te paracaktuara nga studentet. Rezultati i pritur nr.1,4,5 dhe 6.
<b>Java e katërbëdhjetë</b>	<b>Teoria e lojërave dhe sjellja strategjike;</b> Ne kete ligjeratë do te kete ushtrime e perseritje, studentet do te njoftohen me Matricen e rezultateve të një loje. Ekuilibri Nash. Mëdyshja e të burgosurit. Lojëra të përsëritura. Vendosja e një karteli. Lojërat me veprime pasuese. Lojë me pengim të hyrjes, sjellja strategjike ne konkurencen nderkombetare si dhe do te kete diskutim grupor me studentet per prezantimet e studentëve. Rezultati i pritur nr.1,4,5 dhe 6.
<b>Java e pesëmbëdhjetë</b>	<b>Eksternaliteti;</b> Ne kete ligjerate do te kemi perseritje te temave te zhvilluara, pastaj njohje me Eksternalitetet e konsumit dhe Eksternalitetet e prodhimit. Preferencat pothuajse Lineare, dhe ne fund prezantim i punimeve hulumtuese nga studentet. Rezultati i pritur nr.1,4 dhe 6.
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon	

punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimdhënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.